



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGJENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Nr. Org. Org. Instance Org. Unit	AQP
Nr. Prot. Prot. No.	1211/20
Nr. I Fageve Br. Stranica No. Pages	1/1
Data: Datum: Date:	01.07.2020
Prishtinë / a	

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansiye - Ministry of Finance
Agjencia Qendrore e Prokurimit
Centralma Agjencia Nabavke / Central Procurment Agency

DATE/A:	01.07.2020
PËR/ZA/TO:	Autoritetet Kontraktuese
Përmes /Through	Arkivit te AQP-së
NGA/OD/FROM:	Behxhet Rrukiqi, Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Qendrore të Prokurimit/MF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për rishikimin/plotësimin e planeve ekzistuese të dorëzuar në AQP



Të nderuar,

Si rrjedhojë e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, në të cilën ndodhemi për një kohë relativisht të gjatë, e që nuk dihet se sa do të zgjasë kjo gjendje, bazuar në Nenin 8, të LPP-së dhe sipas kërkesave të Autoriteteve Kontraktuese, përkatësisht, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Agjencia Qendrore e Prokurimit/MF, iu mundëson që t'i plotësojnë/modifikojnë planifikimet e prokurimit për vitin 2020, deri më datën 15 korrik 2020. Por, në rast se ka plotësim/ndryshim të Ligjit NR. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, atëherë iu mundësohet edhe një afat shtesë prej 15 ditësh, pas aprovimit dhe publikimit në gazetën zyrtare të ligjit në fjalë, ashtu siç parashihet me Nenin 8, paragrafi 2 i LPP-së.

Pavarësisht nga ky lejim, autoritetet kontraktuese duhet të dorëzojnë në AQP një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve, së paku pesë (5) ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit, me çka konsiderohet se është përmbushur kërkesa ligjore, siç parashihet me Nenin 9, paragrafi 1.

Me respekt

Faqe 1 nga 1